



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 18.02.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Oerd Bylykbashi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”.

Marrin pjesë:

Oerd Bylykbashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Tom Doshi, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Armando Prenga, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Vasilika Hysi.

Të ftuar:

Astrit Kuka – drejtor i Pagave dhe i Pensioneve në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Astrit Hado – zëvendës drejtor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore

HAPET MBLEDHJA

Miratohet procesverbali.

Oerd Bylykbashi – Kuorumi i mbledhjes së komisionit formohet, kështu që fillojmë.

Në rendin e ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”.

Të ftuar janë: zoti Astrit Kuka, drejtor i Pagave dhe i Pensioneve në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe zoti Astrit Hado, zëvendës drejtor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Si fillim, ftoj përfaqësuesit e ministrisë të bëjnë një prezantim të shkurtër në lidhje me qëllimin e këtij projektligji.

Astrit Kuka – Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore” është përgatitur në zbatim të detyrave që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe në përputhje me rregulloren e përcaktuar nga Këshilli i Europës dhe nga Komisioni European, i rregullores nr. 883 të vitit 2004, ku përcaktohen procedurat dhe mënyrat e koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore. Në thelb, marrëveshja bazohet në katër parime themelore: së pari, parimi i barazisë midis shtetasve, pra trajtimi i barabartë i shtetasve të të dyja vendeve; së dyti, është bashkimi i periudhave të sigurimit; së treti, është e drejta e eksportimit të përfitimeve dhe, së katërti, ruajtja e të drejtave të fituara. Kjo marrëveshje është përgatitur për degët e sigurimit shoqëror dhe për pjesën e sigurimit shëndetësor vetëm për sigurimin vullnetar të vazhduar. Në thelb, marrëveshja bën bashkimin e periudhave të sigurimit, e cila u mundëson dhënien e përfitimeve të gjithë atyre shtetasve, të cilët, për një arsye ose për një tjetër, nuk kanë plotësuar periudhat minimale të sigurimit në vendet respektive. Për shembull, nëse një shtetas shqiptar nuk i ka plotësuar 15 vjet sigurim në Shqipëri, ai nuk përfiton asnjë lloj pensioni. E njëjta situatë është edhe në Luksemburg, i cili ka si periudhë minimale 15 vjet. Në këto kushte, me qëllim që të mundësohet dhënia e përfitimit për periudhat që X ka punuar në të dyja vendet, ato bashkohen. Konkretisht, nëse jemi para rastit që për 14 vjet X ka punuar në Shqipëri dhe 10 vjet në Luksemburg, po të mos kishte marrëveshje, ai nuk do të merrte asnjë lloj përfitimi, as në Shqipëri, as në Luksemburg. Në kushtet kur kemi marrëveshje, bashkohen të dyja periudhat dhe konsiderohet sikur X ka 24 vjet sigurim. Pastaj fillon

llogaritja e pensionit, e cila i jepet mbi bazën prorata, pra duke llogaritur që secili të japë pjesën e tij.

Gjithashtu, marrëveshja, pavarësisht se është e përqendruar te pensionet, përfshin edhe degë të tjera të sigurimit shoqëror, qoftë të barrë lindjes, të sëmundjes, të papunësisë, sigurisht duke respektuar legjislacionin reciprok të secilit vend.

E rëndësishme të theksojmë është fakti se edhe për këto degë njihet bashkimi i periudhave, për aq sa është e nevojshme. Pra, nëse në Luksemburg kërkohet një periudhë minimale për përfitimin e papunësisë prej 6 muajsh, pra personi shkon në punë, por nuk ka plotësuar 6 muaj, por 4 muaj, ndërkohë që ka qenë pa shkëputje në punë në Shqipëri, i njihet si periudhë për ta futur në kushtet për të përfituar. E njëjta gjë ndodh edhe me barrë lindjen. Pra, periudha minimale e domosdoshme për barrë lindjen edhe Luksemburgu e ka 12 muaj sigurim shoqëror. Nëse ndodh situata që, pa plotësuar 12 muaj, i lind e drejta, atëherë për ta përfituar këtë të drejtë, bashkohet sigurimi shoqëror që ka në Shqipëri.

Ndërsa sigurimin shëndetësor, pala e Luksemburgut nuk e pranoi për faktin se ndërmjet legjislacioneve tona ka një ndryshim thelbësor. Ligji ynë për sigurimet shëndetësore është i ndërtuar i tillë që sigurimi të jetë individual, ndërsa në ligjin e tyre sigurimi është familjar. Do thotë se, nëse kryefamiljari është i punësuar, të gjithë anëtarët e familjes konsiderohen të siguruar për sigurimin shëndetësor. Si rrjedhim, nëse një nga Luksemburgu punon në Shqipëri, e gjitha familja e tij është e siguruar nga pikëpamja shëndetësore dhe të gjitha shpenzimet për sigurimin shëndetësor të tyre në Luksemburg do të përballoheshin nga pala jonë. Në këto kushte, u pranua vetëm fakti i sigurimit shëndetësor vullnetar të vazhduar. Kjo është në përfitim të shtetasve shqiptarë, sepse Luksemburgu ka një periudhë parakualifikimi për sigurimin shëndetësor, e cila është rreth 6 muaj. Nëse një person është në Luksemburg dhe nuk i ka plotësuar 6 muajt, nuk futet në sigurim shëndetësor. Në këto kushte, nëse në Shqipëri ka bërë një sigurim vullnetar, këtë periudhë ata do ta rinjohin për efekt kualifikimi për sigurimin shëndetësor atje. Është thjesht për shtetasit tanë.

Një gjë tjetër e rëndësishme është fakti që në rastet e bashkimit të periudhave midis dy shteteve, kur nuk realizohet minimumi i domosdoshëm, është parashikuar marrëveshja që të mund të merren në konsideratë periudha të tjera në shtete të tjera, me të cilat ne kemi marrëveshje, por edhe pala tjetër ka marrëveshje. Kjo do të thotë se, nëse një shtetas shqiptar ka 5 vjet në Shqipëri, 5 vjet në Luksemburg, 7 vjet në Belgjikë, atëherë bashkohen të gjitha periudhat për të marrë përfitimin, domethënë, gradualisht po mbyllet cikli dhe kudo që të ketë punuar brenda Europës, sepse me Rumaninë, me Hungarinë, me Luksemburgun, me Belgjikën kemi marrëveshje, edhe me Gjermaninë edhe me Austrinë

kemi filluar, në çdo periudhë, mjafton që këto të gjitha bashkë të bëjnë 15 vjet. Këto ishin gjërat më kryesore. Jemi të hapur për çdo pyetje.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Kuka!

Relatore e komisionit për projektligjin e sotëm është zonja Silva Caka.

Zonja Caka, keni fjalën.

Silva Caka – Në fakt, zotëria i ezauroi të gjitha elementet e marrëveshjes. E vetmja gjë që unë do të kërkoj është që votimi të jetë unanimit, pasi në princip këto janë marrëveshje që i ndihmojnë emigrantët tanë në të gjitha vendet e Europës. Pavarësisht se numri i emigrantëve tanë në Luksemburg nuk është shumë i ndjeshëm, gjithsesi le ta votojmë në parim këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – A ka pyetje nga anëtarët e komisionit në lidhje me projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje? Nuk ka pyetje.

A ka diskutime në parim, para se të kalojmë në votim? Nuk ka.

Ju ftoj ta votojmë në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. A ka pyetje ose diskutime? Nuk ka. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji nga Komisioni i Ligjeve.

Këtu mbyllem këtë çështje dhe mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Falënderoj të ftuarit e ministrisë për prezantimin!

Gjithë të mirat!

MBLEDHJA MBYLLET

Sekretar
Armando Subashi